



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale lidhur me nenin 78 të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në zbatim të nenit 21 të Ligjit për pagat e nëpunësve civil N.03/L-147 dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, Kryetari i Komunës në cilësinë e Organit më të Lartë Administrativ dhe Punëdhënës merr këtë:

V E N D I M
P Ë R
LEJIMIN E KOMPENSIMIT PËR PUNË JASHTË ORARIT

1.Me këtë vendim, zyrtarëve publik Kushtrim Qerimi dhe Alban Shahiqi Aktorë, u **Lejohet Kompensimi** i orëve të punuara jashtë orarit punues gjatë ditëve të vikendit dhe ditëve të punës për muajt nëntor dhe dhjetor 2022 të rritura për 50 % dhe 30% konform ditëve të punuara e që do të kompensohen në të holla, si në vijim:

- 1.1 Kushtrim Qerimi për pagesë.....136.33 €
1.2 Alban Shahiqi për pagesë136.33 €

2. Llogaritja e orëve për pagesë të punuara jashtë orarit punues gjatë ditëve të javës dhe vikendit është bërë sipas nenit 8 paragrafi 4 nënparagrafi 4.2 dhe 4.5 të Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, e ku pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e orëve të punuara dhe llogaritja e tyre.

3.Pjesë përbërëse e këtij vendimi është; raporti i punës së nëpunësve civil nga pika 2 e këtij vendimi.

4.Pagesa për orët e punuara jashtë orarit punues duhet bërë nga kodi buxhetor Paga dhe mëditje – Teatri.

5.Vendimi hynë në fuqi me aktin e nënshkrimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Nëpunësve
- NJBNJ

Kryetari i Komunës
Alban Hyseni